



Pranimi / Dorëzimi Prilopori / Priloga Received / Delivery	08.12.2021	1	viti god year
Organ / Ijësia Organ / Institution Org / Unit	Dr Prot Dr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMSHICK	5884/2021		1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Anr.858/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Avdyll Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.858/2021 të datës 11.10.2021, të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat me adresë rruga "Fehmi Agani", Hyrja Nr. 154, Kati 1, Nr. 8 në Prishtinë, kundër Vendimit me Nr.644/21 të datës 13.09.2021 të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 07.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. SHFUQIZOHET Vendimi me Nr.644/21 i datës 13.09.2021 i Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë lidhur me masën disiplinore ndaj ankuesit Drejtor i Përgjithshëm në AKEE në ME.

II. OBLIGOHET Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, që të bëjë RISHQYRTIMIN e lëndës ndaj ankuesit Drejtor i Përgjithshëm në AKEE në kuadër ME, brenda afatit prej 15 ditë nga dita e pranimi të këtij vendimi.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ministrja e Ministrisë së Ekonomisë më datë 21.07.2021 ka parashtruar kërkesë tek Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshëm që ndaj ankuesit i Përgjithshëm në Agjencisë e Kosovës për Eficiencë të Energjisë të filloj procedura disiplinore pranë Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë. ndërsa më datë 30.07.2021 kërkesën për fillim të procedurës disiplinore të arsyetuar e ka dorëzuar tek Kryesuesi i Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë.

Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë më datë 13.08.2021 ka nxjerr Vendim me Nr. 0504 me të cilin ka bërë pezullimin nga detyra të ankuesit, duke e bërë edhe ndalimin e pagës deri në një vendim përfundimtar.

Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë më datë 13.09.2021 ka nxjerr Vendim me Nr.644/21 më të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore *“ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë pesë (5) vjet”*.

Fillimisht Ministrja e Ministrisë së Ekonomisë, më datë 17.09.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.644/21 të datës 13.09.2021 të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, mirëpo Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka vendosur për ankesën për faktin që ka qenë jofunksional.

Ankuesi, i pakënaqur me Vendimin me Nr.644/21 të datës 13.09.2021 të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes përfaqësuesit të tij më datë 11.10.2021 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot:4980/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.10.2021 ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme. Më datë 26.10.2021 kemi pranuar përgjigje në ankesë nga Sekretariati i Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë.

Kryetari i Kolegjit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, më datë 22.11.2021 ka parashtruar kërkesë tek Kryesuesi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që ankesës së ankuesit ti shtyhet afati për vendosje për dhjetë (10) ditë pune për shkak të rrethanave të funksionimit të Këshillit. Kryesuesi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 22.11.2021 ka nxjerr Vendim VK.nr.56/2021 me të cilin ka aprovuar kërkesën duke bërë vazhdimin e afatit për vendosje edhe për dhjetë (1) ditë pune për ankesën e ankuesit

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot:4980/2021 të datës 11.10.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.644/21 të datës 13.09.2021 të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë; Procesverbalin e datës 10.09.2021 të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë; Kërkesën/Raportim i datës 21.07.2021 nga Ministria e Ministrisë së Ekonomisë;

Memorandumin e Mirëkuptimit i datës 26.08.2020; Vendimin e datës 03.07.2021; Vendimin e datës 03.08.2021; Vendimin e datës 17.12.2019; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 18.10.2021; Përgjigjen në ankesë e datës 26.10.2021; Raportin përfundimtar i Auditimit i datës 15.06.2021; Kërkesën e datës 30.07.2021 për fillimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit; Shkresat e datës 12.11.2020; Shkresën për leje për pajisje më vulë e datës 17.11.2020; Vendimin e datës 11.12.2020; Vendimin e datës 03.11.2020; Procesverbalin nga komisioni për pajisje me vulë i datës 11.12.2020; emalin e datës 01.06.2021 nga Emailin e datës 01.06.2021 nga Shkresë e datës 17.11.2020; Shkresën për leje për pajisje më vulë e datës 17.12.2020; Procesverbalin nga komisioni për pajisje me vulë i datës 23.02.2021; Vendim i datës 23.02.2021; Vendimin Nr. 01/05 të datës 05.04.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendimin e datës 03.03.2021; Emalin e datës 26.05.2021 nga Emailin e datës 26.05.2021 nga Emailin e datës 27.05.2021 nga Shtojcën 2 protokollit i madh; Thirrjen për aplikim e datës 08.02.2021 nga Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë; Formularin e aplikimit; Shkresën për buxhet; Emailin e datës 18.06.2021 nga ankuesi; Emailin e datës 11.06.2021 dhe 30.04.2021 nga Shkresën njoftuese lidhur me procesin e subvencioneve për Biznese dhe Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme e datës 06.05.2021; Vendimin me Nr. 0504 i datës 13.08.2021 i Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë; Vendimin me Nr. 0503 i datës 13.08.2021 i Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë; Raportin përfundimtar i Auditimit i datës 06.07.2021; Draft raportin e auditimit për komentim i datës 25.06.2021; Emailin e datës 03.08.2021 nga për ankuesin; Raportimin financiar janar-mars i datës 06.04.2021 nga Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë; Shkresë lidhur me shpenzimet janar-mars 2021; Rekapitullimin për muajin janar, shkurt dhe mars 2021; Pasqyrën e rrjedhjes së parasë për periudhën 10 janar deri 31 mars 2021; Qarkullimin në periudhën 01.01.-31.03.2021 nga Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë; Vërtetimin Tatimor i datës 30.03.2021; Raportimi financiar për tremujorin e dytë 01.04-30.06.2021; Raportin e shpenzimeve datë 01.04-30.06.2021; Rekapitullimi për muajin prill, maj dhe qershor 2021; Pasqyrën e rrjedhjes së parasë për periudhën 01.04-30.06.2021; Qarkullimi në periudhë 01.04-30.06.2021; Vërtetim Tatimor i datës 30.06.2021; Përgjigjen në shkresën e datës 04.03.2021; Emailin e datës 29.10.2020 nga Emailin e datës 30.10.2020 nga Vendimin Nr.1955 i datës 03.11.2020; Kërkesë për pajisje me vulë e datës 12.11.2020; Shkresën për pajisje me vule e datës 16.11.2020; Emailin e datës 04.12.2020 nga Emailin e datës 04.12.2020 nga Emalin e datës 16.06.2021 nga Procesverbalin e seancës disiplinore i datës 31.08.2021, 17.08.2021; Emalin e datës 01.02.2021 nga Vendim i datës 25.02.2020; Urdhër obligim për pagesë e datës 08.10.2020; Urdhërblerja e datës 08.10.2020; Ndarjen buxhetore prej një milion euro për subvencione dhe transfere në bazë të ligji për ndaje buxhetore për vitin 2021; Emailin e datës 22.07.2021 nga Emailin e datës 08.10.2021 nga Emalin e datës 08.10.2021 nga ankuesi; Memorandum mirëkuptimi i datës 26.08.2020; Emalin e datës 10.09.2021 dhe 08.09.2021 nga për Kërkesën për KASH 2019-2021 sipas instruksioneve nga Minisrti i Financave për përgatitjen e dokumentit e datës 13.03.2018; Emalin e datës 08.09.2021, 07.09.2021 nga Emailin e datës 07.09.2021 nga për Shkresë e datës 02.04.2021 nga Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë; Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2019-2021 nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik; Tabela 1 e trendëve të financimit 2017-2018 dhe vlerësimet 2019-2021; Tabela e tjera lidhur me propozimet për politika të reja të cilat organizatat buxhetore i ka përfshire në tabelën 1; Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2020-2022 nga Ministria e Financave; Procesverbal i seancës disiplinore i datës 13.08.2021; Kërkesën për shtyrje të afatit për vendosjen e ankesës e datës 22.11.2021; Vendimin VK.nr.56/2021 i datës 22.11.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se ekziston bazë e mjaftueshme që lëndën ta rikthej për rishqyrtim tek Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë. *sepse:*

Ankuesi në ankesën e tij të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që Vendimi Nr.644/21 i datës 13.09.2021 i nxjerr nga Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi sepse: me rastin e inicimit të procedurës disiplinore Ministria e Ministrisë së Ekonomisë nuk ka bërë kualifikimin i shkeljes disiplinore; Në seancën e datës 17.08.2021 njëri nga anëtarët e Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë nuk ka marr pjesë në seancë disiplinore me çka është bërë shkelje procedurale; Njëri nga anëtarët e Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë nuk plotëson kushtet për emërim në pozitën e anëtarit sepse nuk ka 3 vite përvojë punë në pozitën e nivelit të lartë drejtues; Po ashtu Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë nuk ka arritur të konstatoj drejtë gjendjen faktike sepse në vendim ka konstatuar që me veprimet e ankuesit ka mundur të ndodhë pasoja duke mos vërtetuar se a ka ndodhur apo jo pasoja.

Bazuar në dispozitat ligjore në fuqi për zyrtarët publikë, konkretisht, bazuar në nenin 48 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, është përcaktuar që: ***“Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil”***, në rastin konkret Ministria e Ministrisë së Ekonomisë në bazë të kërkesës së datës 30.07.2021, ka bërë kualifikimin e saktë të shkeljes disiplinore, sipas dispozitave të nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, i cili përcakton se: ***“Në rast se informacioni i marrë rezulton të ketë elemente si shkelje disiplinore, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë bën kualifikimin e shkeljeve sipas nenit 46 të Ligjit”***, rrjedhimisht në bazë të kësaj kërkesë është vlerësuar që kemi të bëjmë me shkelje të rëndë të detyrave të punës nga ankuesi të përcaktuara me nenin 46 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, kështu që Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se pretendimi ankimor i ankuesit se me rastin e inicimit të procedurës disiplinore Ministria e Ministrisë së Ekonomisë nuk ka bërë kualifikimin i shkeljes disiplinore, është i pabazuar dhe nuk qëndron si i tillë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke e shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon që në seancën e datës 17.08.2021 njëri nga anëtarët e Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë nuk ka marr pjesë në seancë disiplinore, ka konstatuar që Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative në bazë të Aktgjykimin A.nr.500/16, ka potencuar që mospjesëmarrja e një anëtari në komision respektivisht në seancë fillestare nuk është që ndikon asgjë në proces të vendimmarrjes, si rrjedhojë e kësaj, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se njëri nga anëtarët e Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë nuk plotëson kushtet për emërim në pozitën e anëtarit sepse nuk ka 3 vite përvojë punë në pozitën e nivelit të lartë drejtues, ka konstatuar se neni 23 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 i Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, përcakton se: ***“KSHVD, përbëhet nga: dy (2) nëpunës të kategorisë së lartë drejtuese – anëtarë të komisionit”***, ndërsa paragrafi 3 i këtij neni përcakton se: ***“Kandidatët si në paragrafin 2.2 të këtij neni përzgjidhen dhe propozohen nga udhëheqësi i KSHVD-së nga lista e kandidatëve si në paragrafin 3 të nenit 9 të kësaj Rregullore”***. Prandaj duke u nisur nga ky pretendim i ankuesit Kolegji konstaton se ekziston bazë e mjaftueshme që

këtë pretendim ta konstatoj KSHVD me qëllim që të sqarohet se a janë plotësuar kriteret formale nga ana e anëtarëve të KSHVD për zhvillim të rregullt të procedurës ndaj ankuesit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar pretendimin e ankuesit që nuk ka vepruar në kundërshtim me nenin 53 të Ligjit për Menagjimin e Financave Publike i cili përcakton se:

Kufizimet në Grante, Donacione dhe Subvencione 53.1

Asnjë organizatë buxhetore ose autoritet publik nuk mund të japin një grant, donacion ose subvencion për një person ose ndërmarrje, përveç dhe deri në masën e lejuar shprehimisht nga një ligj mbi ndarjet buxhetore.

Prandaj KSHVD është i obliguar të trajtoj saktë arsyen e mos zotimit të mjeteve nga ana e ZKF-së së Ministrisë së Ekonomisë për faktin se mjetet kanë qenë në bugjet të parapara për këtë qëllim në Kodin përkatës. Në Vendimin e KSHVD është dhënë një formulim i përgjithshëm citoj "**Me datë 30.04.2021 ZKF i Ministrisë së Ekonomisë e refuzon kërkesën e z [] për zotim të mjeteve financiare në vlerë 559,494,60€...**", Kolegji konstaton se KSHVD duhet të sqaroj në detaje arsyen e mos zotimit të mjeteve të kërkuara nga ana e ankuesit [], sepse mjetet kanë qenë në kodin bugjetor të parapara për qëllimin e caktuar, KSHVD në këtë rast duhet të ketë parasysh me rastin e trajtimit të kësaj të gjeture se këtu bëhet fjalë për subvencionim dhe nuk kem të bëjmë me Prokurim Publikë.

Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.644/21 të datës 13.09.2021, ka potencuar që ankuesi ka bërë nënshkrimin e kontratave me gjashtëmbëdhjetë (16) përfituesit pa u përfunduar afati i ankesave duke mos respektuar afatet ligjore për ankesë prej 8 ditësh sipas Udhëzimit Administrative (MTI) Nr.01/2018 për Ndarjen e Mjeteve Financiar nga Kategoria Ekonomike e Subvencioneve dhe Trenasfereve të Ministrisë së Inovacionit, në këtë rast Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në këtë konstatim por edhe bazuar në deklaratimet e ankuesit në seancën disiplinore të datës 31.08.2021 të mbajtur nga Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, ndër të tjera ankuesi pranon që janë nënshkruar kontratat pa kaluar afati për ankesë, Kolegji konstaton se kjo pikë nuk ka nevojë të trajtohet nga ana e KVSHD-së.

Gjithashtu Kolegji konstaton se sa i përket kriterëve të përcaktuara nga ana e ankuesit për subvencionimin e energjisë Efiçiente nuk ka nevojë të trajtohen, sepse janë trajtuar mjaftueshëm nga ana e KVSHD-së.

Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë me rastin e rishqyrtimit të lëndës së ankuesit **Drejtor i Përgjithshëm në AKEE me rastin e përcaktimit se a është përgjegjës ankuesi a po jo duhet të ketë parasysh nenin 45 të Ligjit nr.06/L-114 i cili përcakton se:**



Neni 45
Përgjegjësia disiplinore

1. Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit.

Ndërsa sa i përket pikës për çështjen e Vulave KSHVD e ka konstatuar me të drejtë si shkelje e lehtë dhe nuk është në dëmenin e KSHVD që ti trajtoj shkeljet e lehta.

Prandaj Kolegji konstaton se për të ardhur deri tek një vendim përfundimtar dhe i ligjshëm është e nevojshme që nga ana e Këshillit Shtetërorë për Vlerësim dhe Disiplinë të trajtohen edhe një herë pikat të cilat ka kërkuar Këshilli, dhe të nxirret një arsyetim ashtu siç e kërkojnë dispozitat ligjore në fuqi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.858/2021

Avdyj BEKTESHI


Procesmbajtës



Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat
- Ministres së Ministrisë së Ekonomisë;
- Ministrin të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Sekretarët të Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë;
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Ekonomisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

